



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti i Aviacionit Civil
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva
Civil Aviation Authority

Drejtori iPërgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të paragrafit 3 tënenit21 të Ligjit Nr. 03/L-051për Aviacionin Civil,

Duke pasur parasysh nënshkrimin nga UNMIK-u të“MarrëveshjesShumëpalëshepër Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane tëAviacionit (“Marrëveshja HPEA”) në emër të Kosovës, dhe hyrjes së përkohshme në fuqi të Marrëveshjes HPEA në Kosovë më 10 tetor 2006,

Me qëllim të përcaktimit të rregullave mbi Organizimin e Orarit të Punës së anëtarëve të ekuipazhevetë avionëve në Kosovë, në përputhje me MarrëveshjenHPEA dhe kërkesësë saj që Direktiva e Këshillit të Bashkimit Evropian 2000/79/EC të bëhet pjesë e rendit të brendshëm ligjor të Republikës së Kosovës,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE Nr. 2/2008 MBI
ORGANIZIMIN E ORARIT TË PUNËS SË ANËTARËVE TË EKUIPAZHEVE TË AVIONËVE

Neni 1

Kjo Rregullore vlen për orarin e punës së anëtarëve të ekuipazheve të avionëve.

Neni 2

Në këtë Rregullore:

“Orari i punës” do të thotë periudha gjatë së cilës një punonjës punon në dispozicion të punëdhënësit dhe i cili kryen aktivitetet apo detyrat e tij, në përputhje me ligjet kombëtare dhe/ose praktikën e Republikës së Kosovës.

“Anëtarë të ekuipazheve të avionëve” do të thotë anëtarët e ekuipazhit në bord të njëavioni civil të punësuar nga një ndërmarrje e themeluar në Republikën e Kosovës.

“Blloku i kohës së fluturimit” do të thotë koha ndërmjet lëvizjes së parë të avionit nga vendparkimi i tij me qëllim të ngritjes e deri në ndalje në pozitën e caktuar për parkim dhe pas ndaljes së të gjithë motorëve.

“Marrëveshja HPEA” do të thotë Marrëveshja Multilaterale ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të saj, Republikës së Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë lidhur me Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit;

Neni 3

1. Anëtarët e ekuipazheve të avionëve kanë të drejtë në pushim vjetor me pagesë prej të paktën katër javëve, në përputhje me kushtet që rregullojnë të drejtat dhe dhënien e pushimit të tillë të parashikuar nga legjislacioni dhe/ose praktika në Republikën e Kosovës.
2. Periudha minimale e pushimit vjetor me pagesë nuk mund të zëvendësohet me kompensim, përveç nëse shkëputet marrëdhënia e punës.

Neni 4

1. (a) Anëtarët e ekuipazheve të avionëve kanë të drejtë në kontrollim shëndetësor pa pagesë para caktimit në detyrë dhe më tutje në periudha të rregullta.

(b) Anëtarët e ekuipazheve të avionëve të cilët vuajnë nga probleme shëndetësore, për të cilat dihet se janë të ndërlidhura me punën gjatë orarit të natës, do të transferohen sa herë që është e mundur në punë ditore si anëtarë të ekuipazheve ose jo, për cilatdo që mund të jenë të përshtatshëm.
2. Kontrollimi shëndetësor pa pagesë i përmendur në paragrafin 1(a) duhet të jetë në pajtueshmëri me konfidencialitetin mjekësor.
3. Kontrollimi shëndetësor pa pagesë i përmendur në paragrafin 1(a) mund të kryhet në kuadër të sistemit kombëtar shëndetësor në Republikën e Kosovës.

Neni 5

1. Anëtarët e ekuipazheve të avionëve do të gëzojnë mbrojtje të duhur sigurie dhe shëndetësore, të përshtatshme për natyrën e punës së tyre.
2. Shërbime dhe pajisje të përshtatshme parandaluese për siguri dhe mbrojtje të shëndetit të anëtarëve të ekuipazheve të avionëve do të jenë në dispozicion nëçdo kohë.

Neni 6

1. Punëdhënësi, i cili synon të organizojë punën në përputhje me një model të caktuar, duhet të marrë parasysh parimin e përgjithshëm të adaptimit të vendit të punës për punonjësin. Nëse kjo nuk bëhet, atëherë mund të aplikohet një gjobë në përputhje me nenin 97 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil.

Neni 7

Informatat që kanë të bëjnë me modelet e caktuara të punës së anëtarëve të ekuipazheve të avionëve duhet t'u ofrohen autoriteteve kompetente, nëse ata e kërkojnë këtë.

Neni 8

1. Orari i punës duhet të shqyrtohet pa paragjykuar ndonjë legjislacion të ardhshëm të HPEA-së lidhur me kufizimet rreth fluturimeve dhe orarit të punës dhe kërkesave të pushimit dhe në bashkërendim me legjislacionin kombëtar mbi këtë temë i cili duhet të merret parasysh në të gjitha çështjet e ndërlidhura.
2. Koha maksimale vjetore e punës, përfshirë disa elemente të gjendjes në gatishmëri për detyrë siç është përcaktuar me ligjin në fuqi është 2000 orë, përbrenda të cilave blloku i kohës së fluturimit duhet të jetë i kufizuar në 900 orë.
3. Koha maksimale vjetore e punës duhet të shpërndahet në mënyrë sa më të barabartë dhe praktike gjatë vitit.

Neni 9

Pa paragjykuar nenin 3, anëtarëve të ekuipazheve të avionëve duhet t'u jepen ditë të lira nga çdo detyrë apo gjendje gatishmërie të cilat njoftohen paraprakisht, si në vijim:

- a) Të paktën shtatë ditë lokale në çdo muaj kalendarik, ku mund të përfshihen edhe periudha pushimi të kërkuara me ligj; dhe
- b) Të paktën 96 ditë lokale në çdo vit kalendarik, ku mund të përfshihen periudha pushimi të kërkuara me ligj.

Neni 10

1. Autoritetet përkatëse në Republikën e Kosovës mund të vendosin dispozita më të favorshme se ato të parashikuara me këtë Rregullore.
2. Zbatimi i kësaj Rregulloreje në asnjë rrethanë nuk përbën arsye të mjaftueshme për të arsyetuar zvogëlimin e nivelit të përgjithshëm të mbrojtjes së punonjësve në sferat që mbulohen nga kjo Rregullore. Kjo nuk paragjykon të drejtat e autoriteteve përkatëse në Republikën e Kosovës dhe/ose autoriteteve menaxhuese apo të punës për të vendosur, për shkak të rrethanave të ndryshme, kornizë tjetër ligjore, marrëveshje rregullore apo kontraktuese, nga ato që mbizotërojnë në kohë miratimit të kësaj Rregulloreje, me

kusht që gjithnjë të jenë në pajtueshmëri me kushtet minimale të parashikuara me këtë Rregullore.

Neni 11

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 2 dhjetor të vitit 2008.

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm
Autoriteti i Aviacionit Civil